FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 215

Tiranë – E hënë, 14 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 126/2015 datë 26.11.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, faza I, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për fuqizimin institucional për programin "Infrastruktura bashkiake III/IV", furnizimi me ujë dhe kanalizime për vendndodhjet Berat-Kuçovë, Delvinë, Gjirokastër, Kamëz, Librazhd dhe Lushnjë.....	14313
Ligj nr. 127/2015 datë 26.11.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, faza I, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për shërbime të ekspertëve ndaj përfituesit, në kuadrin e studimeve të fizibilitetit, për programin "Infrastruktura bashkiake III/IV", të financuar nga fonde të veçanta, të siguruara nga qeveria gjermane.....	14316
Ligj nr. 128/2015 datë 26.11.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 6, të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për forcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.....	14320
Ligj nr. 129/2015 datë 26.11.2015	Për ratifikimin e vendimit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian - Shqipëri, 1/2015, i datës 11.5.2015, që zëvendëson Protokollin 4 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, në lidhje me përkufizimin e konceptit "produkte origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.....	14322
Ligj nr. 130/2015 datë 26.11.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunimin policor.....	14325
Ligj nr. 131/2015 datë 26.11.2015	Për Qendrën Kombëtare të Biznesit.....	14332

LIGJ
Nr. 126/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, FAZA I, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR FUQIZIMIN INSTITUCIONAL PËR PROGRAMIN "INFRASTRUKTURA BASHKIAKE III/IV", FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME PËR VENDNDODHJET BERAT-KUÇOVË, DELVINË, GJIROKASTËR, KAMËZ, LIBRAZHD DHE LUSHNJË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit, faza I, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për fuqizimin institucional për programin "Infrastruktura bashkiake III/IV", furnizimi me ujë dhe kanalizime për vendndodhjet Berat-Kuçovë, Delvinë, Gjirokastër, Kamëz, Librazhd dhe Lushnjë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9334, datë 4.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE FINANCIMI
SECO, FAZA 1
E DATËS 28 GUSHT 2015
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (PËRFITUESI), PËR SHUMËN 600,000.00 EURO
(KONTRIBUTI ZVICERAN, FAZA 1, PËR FORCIMIN INSTITUCIONAL BMZ-ID 2020 61 406)
PROGRAMI INFRASTRUKTURA BASHKIAKE III/IV
FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME PËR QYTETET BERAT-KUÇOVË, DELVINË, GJIROKASTËR, KAMËZ, LIBRAZHD DHE LUSHNJË
(PROGRAMI)

Hyrje

Bazuar në Marrëveshjen ndërmjet qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të datës 7 nëntor 2014 (Marrëveshja e Programit), mbi Grantin e Asistencës Financiare për Programin III/IV për Infrastrukturën Bashkiake (Programi) dhe në bazë të Marrëveshjes së datës 11 mars 2014, ndërmjet Sekretarit të Shtetit për çështjet ekonomike të Konfederatës Zvicerane (SECO) dhe KfW-së (Marrëveshja e Delegimit), Përfituesi dhe KfW-ja lidhin si më poshtë Marrëveshjen e Financimit. Për përgatitjen e Fazës I të Programit është dhënë një kontribut financiar (Kontributi Financiar FS, Faza I) me vlerë 2.140.000 euro nga qeveria gjermane nëpërmjet KfW-së në përputhje me Marrëveshjen e Financimit (Marrëveshje Financimi FS, Faza I).

Neni 1
Shuma dhe qëllimi i Kontributit Financiar

1.1 KfW-ja do t'i japë Përfituesit një kontribut financiar deri në 600,000,00 euro (në fjalë: gjashtëqind mijë euro) (Kontributi Zviceran, Faza 1).

Ky Kontribut Financiar nuk do të jetë i shlyeshëm, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi do të përdorë Kontributin Financiar, Faza 1, ekskluzivisht për shërbime të forcimit institucional në fazën përgatitore 1 të Programit (Faza 1 e Forcimit Institucional, siç

përcaktohet me hollësi në Marrëveshjen e Veçantë (këto shërbime do të kryhen nga "Konsulentët institucionalë" në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve (Njësia e Koordinimit të Programit NJKP) dhe Kompanive të Shfrytëzimit të ujit të UK Berat-Kuçovë, UK Delvinë UK Gjirokastër, UK Librazhd, UK Lushnjë dhe departamenti i ujësjellësit i Bashkisë Kamëz (veçmas e referuar si një Agjenci Zbatimi Projekti, "AZP"). Përfituesi, i përfaqësuar nga NJKP-ja dhe AZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojë hollësitë e Programit dhe të Forcimit Institucional, Faza 1, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga Kontributi Zviceran, Faza 1, me anë të një marrëveshjeje të veçantë (Marrëveshje e Veçantë SECO, Faza 1), e cila duhet të miratohet nga Përfituesi.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera shtetërore, që duhet të përballohen nga Përfituesi, NJKP-ja apo konsulentët (duke përfshirë tatimin mbi fitimin), si dhe detyrimet tatimore, nuk do të financohen nga Kontributi Zviceran, Faza 1.

Neni 2
Disbursimi

2.1 KfW-ja do të disbursojë Kontributin Zviceran, Faza 1, në përputhje me progresin e Forcimit Institucional, Faza 1, dhe me kërkesë të Përfituesit, të përfaqësuar nga NJKP-ja. Me anë të Marrëveshjes së Veçantë SECO, Faza 1, KfW-ja, Përfituesi, NJKP-ja dhe AZP-të do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti të dhënat që provojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e paracaktuar.

2.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 31 dhjetor 2016.

Neni 3
Pezullimi i disbursimit dhe i shlyerjes

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç rasteve kur:

a) Përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur ato bëhen të kërkueshme;

b) Detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje Financimi FS, Faza 1, apo në Marrëveshjen e Financimit SECO, Faza 1, apo në Marrëveshjen e Veçantë në lidhje me Marrëveshjen e Financimit SECO, Faza 1 (e cila do të lidhet në lidhje me Programin), janë shkelur;

c) Përfituesi është i paaftë të vërtetojë se shumat e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e përcaktuar; ose

d) Ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin apo qëllimin e këtij Programi; ose

e) Disbursimet nga SECO-ja për KfW-në janë pezulluar apo vonuar.

3.2 Nëse ndonjë nga situatat e specifikuara në nenin 3.1/"b" dhe "c" ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë të paktën 30 ditë. KfW-ja ka të drejtë:

a) Në rastin e nenit 3.1/b, të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjithë shumës së disbursuar;

b) Në rastin e nenit 3.1/c, të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumës për të cilën Përfituesi nuk mund të provojë që është përdorur për qëllimin e paracaktuar.

Neni 4
Kostot dhe pagesat publike

Përfituesi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që paguhen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi FS, Faza 1, si edhe koston e transfertave dhe koston e konvertimit të bëra në lidhje me disbursimin e Kontributit Financiar FS, Faza 1.

Neni 5
Deklarimet kontraktuale dhe përfaqësimi

5.1 Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj, e përfaqësojnë Përfituesin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi FS, Faza 1. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Përfituesit të autorizuar për atë kohë të jetë marrë prej KfW-së.

5.2 Çdo ndryshim apo shtesë në këtë kontratë duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të miratohet nga të gjitha palët. Ministri i Financave autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e bëra në këtë Marrëveshje, që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë, nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë

e tillë do të konsiderohet e marrë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të Palës Kontraktuese apo në ndonjë adrese tjetër të Palës Kontraktuese sipas njoftimit të bërë Palës tjetër Kontraktuese.

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale Gjermane
Faks +49 69 7431 2944

Për Përfituesin: Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë
Shqipëri
Faks (+355) 4 222 8494

Neni 6
Forcimi institucional, Faza 1

6.1 Përfituesi, i përfaqësuar nga Njësia e Koordinimit të Programit, merr masa vetë dhe merr, gjithashtu, masa që çdo Agjenci e Zbatimit të Projektit, të:

a) Përgatitë dhe të zbatojë, Forcimin e Institucional, Faza 1, në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe teknike, kryesisht në pajtim me konceptin e Programit të rënë dakord ndërmjet Njësisë së Koordinimit të Programit, Agjencive të Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) I cakton Zbatimin e Fazës 1 të Forcimit Institucional firmave të konsulente të kualifikuarat pavarura;

c) Pas parapërzgjedhjes dhe tenderimit ndërkombëtar publik, t'u akordojë kontratën konsulente firmave Konsulente të kualifikuara dhe të pavarura (ose përkatësisht në rastin e komponentit Masterplan të mbështetjes institucionale të NJZP-së, pas akordimit të drejtpërdrejtë). Procedura e kontraktimit do të rregullohet nga KfW-ja "Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet partnere" (aneksi 1), i cili është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje;

d) Siguron financim të plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe i jep KfW-së, me kërkesë, të dhëna që provojnë se kostoja e papaguar nga Kontributi Zviceran, Faza 1, është e mbuluar;

e) Mban libra dhe regjistra që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga Kontributi Zviceran, Faza 1;

f) Merr masa që përfaqësuesit e KfW-së të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin, operimin e Programit, si dhe të vizitojë vendin e zbatimit të Programit dhe të gjitha instalimet që lidhen me të;

g) I paraqet KfW-së ose SECO-s çdolloj informacioni dhe raporti mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe në progresin e tyre të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së ose SECO-s;

h) Me miratimin e saj, nëpërmjet NJKP-së, informon menjëherë KfW-në për ndonjë rrethanë që pengon apo rrezikon seriozisht zbatimin, operimin apo qëllimin e Programit;

i) Lejon vlerësimin, rishikimin dhe vizitat e monitorimit nga përfaqësues të SECO-s. SECO-ja ka të drejtën të dërgojë agjentët e saj për të kryer kontrolle dhe inspektime në terren;

j) Në rastet kur NJKP-ja apo AZP-të vendosin për një komitet drejtues apo për një organ të ngjashëm mbikëqyrës në lidhje me Programin që kryen takime të rregullta për të mbikëqyrur, monitoruar dhe në mënyrë strategjike, si dhe për të trajtuar çështjet e përbashkëta, informojnë KfW-në dhe SECO-n për këtë vendim dhe sigurohen që KfW-ja dhe SECO-ja do të kenë të drejtën, me kërkesë të tyre, të emërojnë një përfaqësues për këtë organ mbikëqyrës (nëse ka);

k) Siguron vizibilitetin e Programit për Kontributin Zviceran, p.sh., të gjitha materialet që kanë lidhje me marrëdhëniet publike dhe të gjitha dokumentet e hartuara nga Programi do të përfshijnë si referencë faktin që Programi është bashkëfinancuar nga Qeveria Zvicerane dhe paraqesin logon e Qeverisë Zvicerane; për më tepër sigurohen që Kontributi Zviceran të vërtetohet në tabelat e vendosura në vendet e ndërtimit;

l) Siguron që bashkitë dhe AZP-të do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e burimeve ujore që kanë lidhje me zonat të mbrojtjes së ujit, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

6.2 NJKP-ja, AZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë përkatëse në lidhje me nenin 6.1 me anë të një Marrëveshjeje të Veçantë SECO, Faza 1, e cila duhet të miratohet nga Përfituesi.

Neni 7
Dispozita të ndryshme

7.1 NJKP-ja do të garantojnë se personat që janë ngarkuar me zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve, të kontraktimit të Kontratës për Shërbimet e Ekspertit për t'u financuar dhe kërkuar disbursime të Kontributit Financiar FS, Faza 1, të mos kërkojnë, japin, premtojnë apo marrin një premtim për pagesa të paligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këtë detyrë.

7.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Financimi FS, Faza 1, është e paligjshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj do të përmbushet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

7.3 Huamarrësi nuk mund të kalojë, transferojë, rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga Marrëveshja Financiare SECO, Faza 1.

7.4 Kjo Marrëveshje Financiare SECO, Faza 1, do të rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

7.5 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga Marrëveshja Financiare SECO, Faza 1, ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit do të përfundojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së nevojshme të Programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

7.6 Marrëveshja Financiare FS, Faza 1, nuk do të hyjë në fuqi derisa të plotësohen nga Përfituesi të gjitha procedurat e brendshme ligjore. Përfituesi do të njoftojë KfW-në menjëherë pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Kjo Marrëveshje Huaje nënshkruhet në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Republika e Shqipërisë,
e përfaqësuar nga Ministria e Financave
Nga:
Emri: Shkëlqim Cani
Titulli: Ministër i Financave

KfW

Nga:	Nga:
Emri:	Emri:

LIGJ
Nr. 127/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, FAZA I, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR SHËRBIME TË EKSPERTËVE NDAJ PËRFITUESIT, NË KUADRIN E STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT, PËR PROGRAMIN "INFRASTRUKTURA BASHKIAKE III/IV", TË FINANCUAR NGA FONDE TË VEÇANTA, TË SIGURUARA NGA QEVERIA GJERMANE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit, faza I, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për shërbime të ekspertëve ndaj përfituesit, në kuadrin e studimeve të fizibilitetit, për programin "Infrastruktura bashkiake III/IV", të financuar nga fonde të veçanta, të siguruara nga Qeveria Gjermane, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9335, datë 4.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE FINANCIMI
FS, FAZA 1
E DATËS 28 GUSHT 2015
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (PËRFITUESI)
PËR SHUMËN 2,140,000.00 EURO
(KONTRIBUTI FINANCIAR FS, FAZA 1)

Për shërbime të ekspertëve ndaj përfituesit, në kuadër të studimeve të fizibilitetit për "Programin për infrastrukturën bashkiake III/IV" (BMZ-ID 2011 65 968 dhe 2012 65 867), të financuar nga një fond i veçantë (Studien-Und Beratungsfonds) nr. 9890-9892 të dhënë nga qeveria gjermane.

Bazuar në autorizimet e dhëna nga qeveria gjermane, të datës 31 janar dhe 24 shkurt 2014 dhe me kërkesë të qeverisë shqiptare, sipas Protokollit të Negociatave Qeveritare, të datës 25 shtator 2012, Përfituesi dhe KFW-ja lidhin Marrëveshjen e Financimit, si më poshtë:

Neni 1
Shuma dhe qëllimi i Kontributit Financiar

1.1 KfW-ja do t'i japë Përfituesit një kontribut financiar deri në 2,140,000.00 euro (në fjalë: dy milionë e njëqind e dyzet mijë euro) (Kontributi Financiar FS, Faza 1).

Ky Kontribut Financiar nuk do të jetë i shlyeshëm, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi do të përdorë Kontributin Financiar FS, Faza 1, ekskluzivisht për financimin e Shërbimeve të Ekspertëve, si më poshtë:

Mbështetje për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve (që vepron si Njësia e Koordinimit të Programit "NJKP") gjatë fazës përgatitore 1 të Programit (Programi) Infrastruktura Bashkiake III/IV, duke përpunuar apo zhvilluar studimet e fizibilitetit teknik për vendet e projektit, UK Berat-Kuçovë, UK Delvinë, UK Gjirokastër, UK Librazhd, UK Lushnjë dhe departamentin e ujësjellësit të Bashkisë Kamëz (Shërbimet e Ekspertit).

1.3 Përfituesi do të përdorë kontributet e palës tjetër tërësisht dhe brenda afateve. Përfituesi do t'i paraqesë KfW-së, me kërkesë të saj, të dhëna që provojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera shtetërore, që duhet të përballohen nga Përfituesi, NJKP-ja apo konsulentët (duke përfshirë tatimin mbi fitimin), si dhe detyrimet tatimore nuk do të financohen nga Faza 1 e Kontributit Financiar.

Neni 2
Disbursimi

2.1 Përfituesi, si më poshtë, autorizon KfW-në të kryejë pagesat fillestare, të ndërmjetme dhe përfundimtare nga Kontributi Financiar, Faza 1, ndaj Konsulentit dhe Agjentit të Tenderit. Këto pagesa do të kryhen në përputhje me progresin e Shërbimeve të Ekspertit, bazuar në faturat origjinale që i paraqiten KfW-së (një kopje për Përfituesin) dhe në përputhje me kontratat e konsulencës (të ndryshuara), që do të nënshkruhen ndërmjet NJKP-së dhe konsulentëve, si dhe përkatësisht ndërmjet NJKP-së dhe agjentëve të tenderimit. Ky autorizim nga Përfituesi konsiderohet si një kërkesë për disbursim të të gjitha pagesave të lartpërmendura.

2.2 Për pagesa të kryera në një monedhë të ndryshme nga ajo e rënë dakord (monedha e huaj) KfW-ja do të lëshojë për Përfituesin këtë vlerë në euro, siç është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastit.

2.3 KfW-ja nuk do të jetë përgjegjëse për vonesa të shkaktuara nga transfertat në institucionet bankare, në disbursimin apo dërgimin e çdo pagese të kryer nga KfW-ja. Nëse vonesa shkaktohet nga KfW-ja, përgjegjësia e vetme do të jetë pagesa e interesit të llogaritur.

2.4 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të kryejë pagesa pas datës 31 dhjetor 2016.

2.5 Kontratat e Konsulencës do të përfshijnë një dispozitë që përcakton se çdo rimbursim, garanci apo pagesë e kërkuar do të bëhet për llogari të Përfituesit në llogarinë nr. 38.000 00000 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00), KfW Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00) nga KfW-ja që do të kryejë këto pagesa në llogarinë e Përftuesit.

Neni 3
Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç rasteve kur:

a) Përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur ato bëhen të kërkueshme;

b) Detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje Financimi FS, Faza 1, apo në Marrëveshjen e Financimit SECO, Faza 1, apo në Marrëveshjen e Veçantë në lidhje me Marrëveshjen e Financimit SECO, Faza 1 (e cila do të lidhet në lidhje me Programin), janë shkelur;

c) Përfituesi është i paaftë të vërtetojë se të gjitha shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e caktuar; ose

d) Ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme, që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve të Shërbimeve të Ekspertëve;

e) Kontratat e Konsulencës që duhet të lidhen ndërmjet NJKP-së dhe konsulentëve janë shkelur, përfunduar apo anuluar.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të Kontributit Financiar, Faza 1, nëse ndonjë nga situatat e përcaktuara në nenin 3.1/"b" dhe "c" ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë të paktën 30 ditë. Në rastin e nenit 3.1/"c" shlyerja do të kufizohet në shumën për të cilën Përfituesi nuk mund të provojë që është përdorur për qëllimin e paracaktuar.

Neni 4
Kostot dhe pagesat publike

Përfituesi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që paguhen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi FS, Faza 1, si edhe koston e transfertave dhe koston e konvertimit, të shkaktuara në lidhje me disbursimin e Kontributit Financiar FS, Faza 1.

Neni 5
Deklarimet kontraktuale dhe përfaqësimi

5.1 Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë Përfituesin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi FS, Faza 1. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Përfituesit të autorizuar për atë kohë të jetë marrë prej KfW-së.

5.2 Çdo ndryshim apo shtesë në këtë kontratë duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të miratohet nga të gjitha palët. Ministri i Financave autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e bëra në këtë Marrëveshje, që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë do të konsiderohet e marrë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të Palës Kontraktuese apo në ndonjë adrese tjetër të Palës Kontraktuese sipas njoftimit të bërë Palës tjetër Kontraktuese.

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale Gjermane
Faks +49 69 7431 2944

Për Përfituesin: Republika e Shqipërisë,
e përfaqësuar nga
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët
e Kombit", nr. 1
Tiranë
Shqipëri
Faks (+355) 4 222 8494

Neni 6
Shërbimet e Ekspertit

6.1 Përfituesi:

a) Nëpërmjet NJKP-së, do t'u caktojë Shërbimet e Ekspertëve konsulentëve të pavarur të kualifikuar (Konsulenti), kryesisht në përputhje me konceptin për të cilin kanë rënë dakord mbi Shërbimet e Ekspertit Përfituesi dhe KfW-ja;

b) Të ndjekë përzgjedhjen paraprake dhe tenderimin ndërkombëtar publik konkurrues, nëpërmjet NJKP-së, t'i akordojë kontratën një Konsulenti të kualifikuar dhe të pavarur. Procedura e kontraktimit do të rregullohet nga KfW-ja "Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet partnere" (aneksi 1), i cili është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

c) Siguron financim të plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe i jep KfW-së, me kërkesë, të dhëna që provojnë se kostoja e papaguar nga Kontributi Financiar FS, Faza 1 është e mbuluar;

d) Nëpërmjet NJKP-së, mban libra dhe regjistra që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve

të kërkuara për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga Kontributi Financiar FS, Faza 1;

e) Nëpërmjet NJKP-së, mundëson që përfaqësuesit e KfW-së të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertit;

f) Nëpërmjet NJKP-së, i paraqet KfW-së çdolloj informacioni dhe raporti mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së;

g) Me aprovimin e saj, nëpërmjet NJKP-së, informon menjëherë KfW-në për ndonjë rrethanë që pengon apo rrezikon seriozisht zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve apo qëllimet e tyre;

h) Nëpërmjet NJKP-së, bën komente mbi raportet e Konsulentit apo njofton aprovimin e përmbajtjes nëpërmjet nënshkrimit të raporteve; dhe

i) Merr vendimet mbi të gjitha projektimet, raportet, studimet dhe zëvendësimin e anëtarëve të stafit të Konsulentit në marrëveshje me KfW-në.

6.2 Menjëherë pas përfundimit të Shërbimeve të Ekspertit të vëna në funksionim, KfW-ja do të ketë një numër kopjesh të të gjitha planeve, raporteve, studimeve të kryera nga konsulenti me kërkesë të KfW-së. KfW-ja mund të vlerësojë studimet.

6.3 Nga financimi i Studimit të Përfituesit mund të mos rrjedhë një e drejtë për financimin e projektit, të përgatitur nga studimi. Siç është rënë dakord gjatë negociatave ndërqeveritare, të datës 25 shtator 2012, Përfituesi gjithsesi do t'i ofrojë Republikës Federale të Gjermanisë një mundësi për të financuar projektin nën bashkëpunimin financiar.

Neni 7

Shërbimet e Konsulentit

7.1 Detyrimet e Konsulentit do të përfshijnë, përveç të tjerash dhe kur të jetë e nevojshme, si më poshtë:

- Rishikimin dhe përcaktimin e hollësishëm të masave të parashikuara të investimit;
- Krahasimin e masave teknike alternative;
- Analizimin e zbatimit teknik mbi masat e parashikuara të investimit;
- Inspektimin e sistemeve të kanalizimeve (CCTV);
- Analizimin dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor;
- Analizën e cilësisë së ujit;
- Specifikimin e ndikimit mjedisor dhe klimaterik (aspektet e operimit, duke përfshirë kostot e operimit).

7.2 KfW-ja ka të drejtën e pakushtëzuar të përdorë dhe të shfrytëzojë rezultatet e shërbimeve të ekspertëve dhe të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me të, të financuara nga Kontributi Financiar FS, Faza 1, në çdo kohë dhe vendet në diskrecionin e saj.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 NJKP-ja do të sigurojë se personat që janë ngarkuar me zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve, të kontraktimit të Kontratës për Shërbimet e Ekspertit për t'u financuar dhe kërkuar disbursim e të Kontributit Financiar FS, Faza 1, të mos kërkojë, japë, premtojë apo marrë një premtim për pagesa të paligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këtë detyrë.

8.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Financimi FS, Faza 1, është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj do të përmbushet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.3 Përfituesi nuk mund të kalojë, transferojë, rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

8.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.5 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit do të përfundojnë 6 vjet pas disbursimit përfundimtar.

8.6 Marrëveshja Financiare FS, Faza 1, nuk do të hyjë në fuqi derisa të plotësohen nga Përfituesi të gjitha procedurat e brendshme ligjore. Përfituesi do të njoftojë KfW-në menjëherë pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Kjo Marrëveshje Huaje nënshkruhet në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Tiranë, _____

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga:

Emri: Shkëlqim Cani

Titulli: Ministër i Financave

Tiranë, _____

KfW

Nga: Nga:

Emri: Emri:

Titulli: Titulli:

ANEKSI 1
UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME VENDET PARTNERE

Linku për udhëzimet:
https://www.kfw-entwicklungsbank.de/Internationale-Finanzierung/KfW-entwicklungsbank/Service/Download-Center/Uberblickspublikationen/Richtlinien

LIGJ
Nr. 128/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 6, TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS, QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRITJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË, TË QËNDRUESHME DHE GJITHËPËRFSHIRËSE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr. 6, e marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9336, datë 4.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE E NDIHMËS SË USAID-it, NR. 182-DOAG-13-007
NDRYSHIMI NUMËR GJASHTË I MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRITJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE TË QËNDRUESHME,
DATUAR: 30 SHTATOR 2013

NDRYSHIM NUMËR GJASHTË I MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI

Datë:

Ndërmjet qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë e quajtur "Përfituesi i Ndihmës").

Neni 1
Qëllimi i ndryshimit

Ky ndryshim numër gjashtë i Marrëveshjes së Ndihmës të USAID-it për objektiva zhvillimi, të datës 30 shtator 2013 (Marrëveshja) bëhet midis

palëve me qëllim që t'i japë Përfituesit të Ndihmës: 1. Një shtesë prej dymbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e nëntë mijë dollarë amerikanë (USD) ($12,079,000) të shumës së obliguar; dhe 2. Të shtojë totalin e kontributit të USAID-it në tridhjetë e pesë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy dollarë amerikanë ($35,262,000); dhe 3. Të ndryshojë kontributin e parashikuar.

Neni 2
Kontributi i Palëve

Neni 3, seksioni 3.1/"a" dhe "b" i Marrëveshjes fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë:

"Seksioni 3.1. Kontributi i USAID-it.

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të vendosur në këtë Marrëveshje, USAID-i, në përputhje me Aktin e Ndihmës së Huaj të vitit 1961, siç është ndryshuar, i jep përfituesit të ndihmës, sipas kushteve të Marrëveshjes, një shumë që nuk kalon tridhjetë e dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë ($32,476,953) (Granti).

b) Kontributi total i llogaritur i USAID-it. Kontributi total i llogaritur i USAID-it për arritjen e objektivave do të jetë tridhjetë e pesë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë dollarë amerikanë ($35,262,000), të cilat do të jepen në mënyrë shtuese dhe në bazë të disponueshmërisë së fondeve. Rritjet pasuese do të jenë të kushtëzuara nga disponueshmëria e fondeve të USAID-it për këtë qëllim dhe mund të jepen nga USAID-i pas njoftimit me shkrim dërguar përfituesit të ndihmës. Palët bien dakord që çdo kontribut shtesë i dhënë, sipas rastit, do të rritë në mënyrë kumulative shumën totale të Grantit, të përcaktuar në seksionin 3.1/a. Pas kësaj, përfituesi i ndihmës bie dakord të konfirmojë, me anë të njoftimit me shkrim dërguar USAID-it, këtë kontribut shtesë, nëse ka të tillë.

Neni 3
Plani financiar

Plani financiar sipas shtojcës 1, përshkrimit të zgjeruar, seksioni III, fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë:

"III. PLANI FINANCIAR

Plani financiar për kryerjen e objektivave dhe të rezultateve, paraqitet në tabelën më poshtë:

Nr.	Fusha e programit	Obligime të mëparshme	VF 2015	VF 2015/shtesë	Totali VF 201 –2018
1	Shteti ligjor dhe të drejtat e një	3,939,000	1,750,000	$1,600,000	$6,939,000
2	Qeverisja e mirë	7,571,662	2,911,000	$3,600,000	$13,603,000
3	Shoqëria civile	60,000			$1,000,000
4	Tregtia dhe investimet	500,000			$1,500,000
5	Sektori financiar	2,410,000			$1,950.000
6	Konkurrueshmëria e sektorit privat	2,917,000		$1,518,000	$6,335,000
7	Infrastruktura	0			$0
8	Mbështetje për programin	2,000,291	700,000		$2,935,000
9	Mundësi ekonomike	1,000,000		$0	$1,000,000
	TOTALI	**20,397,953**	**5,361,000**	**$6,718,000**	**$35,262,000**

Neni 4
Gjuha e ndryshimit

Ky ndryshim është përgatitur në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast paqartësie ose konflikti midis dy versioneve, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Neni 5
Rregullat dhe kushtet e tjera

Përveç sa ndryshuar këtu, të gjitha rregullat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes mbeten plotësisht në fuqi. Të gjithë termat me germa kapitale në këtë Ndryshim Numër Gjashtë do të kenë kuptimet që u jepen atyre në marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe përfituesi i ndihmës, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësive të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky ndryshim numër gjashtë i marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara
të Amerikës
Nga:

Datë: 28.8.2015
Emri: Marcus A. Johnson Jr.
Përfaqësuesi i USAID-it/Shqipëri
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Nga:
Datë: 18.9.2015
Emri: Shkëlqim Cani
Pozicioni: Ministër i Financave

LIGJ
Nr. 129/2015

PËR RATIFIKIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BASHKIMI EVROPIAN - SHQIPËRI, 1/2015, I DATËS 11.5.2015, QË ZËVENDËSON PROTOKOLLIN 4 TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT, NDËRMJET KOMUNITETEVE EVROPIANE DHE SHTETEVE TË TYRE ANËTARE, NGA NJËRA ANË, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NGA ANA TJETËR, NË LIDHJE ME PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT "PRODUKTE ORIGJINUESE" DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet vendimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian - Shqipëri, 1/2015, i datës 11.5.2015, që zëvendëson Protokollin 4 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, në lidhje me përkufizimin e konceptit "produkte origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9337, datë 4.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM I KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-SHQIPËRI 1/2015,
I DATËS 11.5.2015,
QË ZËVENDËSON PROTOKOLLIN 4 TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT, NDËRMJET KOMUNITETEVE EVROPIANE DHE SHTETEVE TË TYRE ANËTARE, NGA NJËRA ANË, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NGA ANA TJETËR, NË LIDHJE ME PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT "PRODUKTE ORIGJINUESE" DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Këshilli i Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri,

duke marrë parasysh Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, të nënshkruar në Luksemburg, më 12 qershor 2006[1] dhe në veçanti nenin 41 të saj;

duke marrë parasysh Protokollin 4 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, në lidhje me përkufizimin e konceptit "produkte origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit administrativ,

meqë:

1. Neni 41 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, "Marrëveshja" i referohet Protokollit 4 të marrëveshjes "Protokolli 4", që përcakton rregullat e origjinës dhe sanksionon kumulimin e origjinës ndërmjet Bashkimit Evropian, Shqipërisë, Turqisë dhe çdo vendi apo territori tjetër pjesëmarrës në procesin e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit

[1] GZ L 107, 28.4.2009, faqe 166.

Evropian;

2. Neni 38 i Protokollit 4 sanksionon se Këshilli i Stabilizim-Asocimit, i parashikuar në nenin 116 të Marrëveshjes mund të vendosë për të ndryshuar dispozitat e Protokollit 4.

3. Konventa rajonale për rregullat preferenciale pan-euro-mesdhetare të origjinës[2] "Konventa" synon të zëvendësojë protokollet për rregullat e origjinës, aktualisht në fuqi, ndërmjet vendeve të zonës pan-euro-mesdhetare me një akt juridik të vetëm. Shqipëria dhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin e Stabilizim-Asociimit nga Ballkani Perëndimor u ftuan që t'i bashkohen sistemit pan-evropian të kumulimit diagonal të origjinës, në agjendën e Selanikut të miratuar nga Këshilli Evropian në qershor 2013. Ata u ftuan që t'i bashkohen Konventës me një vendim të Konferencës Ministrore Euro-Mesdhetare të tetorit 2007;

4. Bashkimi Evropian dhe Shqipëria e nënshkruan Konventën përkatësisht më 15 qershor 2011 dhe 27 qershor 2011;

5. Bashkimi Evropian dhe Shqipëria depozituan instrumentet e pranimit pranë depozitarit të Konventës, përkatësisht më 26 mars 2012 dhe 5 mars 2012. Rrjedhimisht, në zbatim të nenit 19, pika 3. të Konventës, Konventa hyri në fuqi më 1 maj 2012, si për Bashkimin Evropian ashtu edhe për Shqipërinë;

6. Protokolli 4 zëvendësohet në këtë mënyrë me një protokoll të ri që i referohet Konventës,

miraton këtë vendim:

Neni 1

Protokolli 4 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, në lidhje me përkufizimin e konceptit "produkte origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, zëvendësohet me tekstin e paraqitur në shtojcën e këtij vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

Vendimi i shtrin efektet nga data 1 maj 2015.

[2] GZ L 54, 26.2.2013, faqe 4

SHTOJCË

PROTOKOLLI 4

NË LIDHJE ME PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT "PRODUKTE ORIGJINUESE" DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Neni 1

Rregullat e zbatueshme të origjinës

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, aplikohen shtojca I dhe dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale pan-euro-mesdhetare të origjinës[3] (Konventa).

2. Të gjitha referencat për "marrëveshje përkatëse" në shtojcën I dhe dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës Rajonale, për rregullat preferenciale pan-euro-mesdhetare të origjinës nënkuptojnë këtë Marrëveshje.

Neni 2

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me procedurat e verifikimit të parashikuara në nenin 32, të shtojcës I, të Konventës, të cilat nuk mund të zgjidhen ndërmjet autoriteteve doganore që kërkojnë verifikimin dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimit, i paraqitet për zgjidhje Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

2. Në të gjitha rastet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues bëhet në kuadër të legjislacionit të atij vendi.

Neni 3

Ndryshimet e Protokollit

Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë të ndryshojë dispozitat e këtij Protokolli.

Neni 4

Tërheqja nga Konventa

1. Nëse Bashkimi Evropian apo Shqipëria dorëzojnë njoftim me shkrim pranë depozitarit të Konventës, ku shprehin qëllimin për t'u tërhequr nga Konventa në zbatim të nenit 9 të saj,

[3] GZ L 54, 26.2.2013, faqe 4

Bashkimi Evropian dhe Shqipëria do të hyjnë menjëherë në bisedime për rregullat e origjinës, me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Deri në hyrjen në fuqi të rregullave të origjinës të negociuara rishtas, rregullat e origjinës të përcaktuara në shtojcën I dhe në rastet kur është e përshtatshme, dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës, të zbatueshme në momentin e tërheqjes, vazhdojnë të zbatohen në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë nga momenti i tërheqjes, rregullat e origjinës, të përcaktuara në shtojcën I dhe në rastet kur është e përshtatshme, dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës, interpretohen në mënyrë të tillë që të lejojnë kumulimin dypalësh vetëm ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

Neni 5

Dispozitat kalimtare-kumulimi

Pavarësisht nenit 16, pika 5, dhe nenit 21, pika 3, të shtojcës I, të Konventës, kur kumulimi përfshin vetëm shtetet EFTA, ishujt Faroe, Bashkimin Evropian, Turqinë dhe pjesëmarrësit në procesin e Stabilizim- Asociimit, dëshmia e origjinës mund të jetë një certifikatë qarkullimi EUR.1 ose një deklaratë origjine.

Съставено в Брюксел на
Hecho en Bruselas, el
V Bruselu dne
Udfærdiget i Bruxelles, den
Geschehen zu Brüssel am
Brüssel,
Έγινε στις Βρυξέλλες, στις
Done at Brussels,
Fait à Bruxelles, le
Sastavljeno u Bruxellesu
Fatto a Bruxelles, addì
Briselē,
Priimta Briuselyje,
Kelt Brüsszelben,
Magħmul fi Brussell,
Gedaan te Brussel,
Sporządzono w Brukseli, dnia
Feito em Bruxelas,
Întocmit la Bruxelles,
V Bruseli
V Bruslju,
Tehty Brysselissä
Utfärdat i Bryssel den
Bërë në Bruksel, më

За Съвета за асоцииране
Por el Consejo de Asociación
Za Radu přidruženi
Pa Associeringsrådets vegne
Im Namen des Assoziationsrates
Assotsiatsiooninõukogu nimel
Για το Συμβούλιο Σύνδεσης
For the Association Council
Pour le Conseil d'association
Za Vijeće za pridruživanje
Per il Consiglio di associazione
Asociācijas padomes vārdā
Asociacijos tarybos vardu
A Társulási Tanács részéről
Ghall-Kunsill ta' l-Assoċjazzjoni
Voor de Associatieraad
W imieniu Rady Stowarzyszenia
Pelo Conselho de Associação
Consiliul de Asociere
Za Asociačnú radu
Za Pridružitveni svet
Assosiaationeuvoston puolesta
Pa associeringsrådets vägnar
Për Këshillin e Stabilizim-Asociimit

Председателя	Секретарите
El Presidente	Los Secretarios
Předseda	Tajemníci
Formand	Sekretærerne
Der Präsident	Die Sekretäre
eesistuja	sekretärid
Ο Πρόεδρος	Οι Γραμματείς
The President	The Secretaries
Le président	Les Secrétaires
Predsjednik	Tajnici
Il Presidente	I Segretari
Priekšsēdētājs	Sekretāri
Pirmininkas	Sekretoriai
Az elnök	A titkárok
Il-President	Is-Segretarji
De Voorzitter	De Secretarissen
Przewodniczący	Sekretarze
O Presidente	Os Secretários
Preşedinte	Secretari
predseda	tajomníci
Predsednik	Sekretarja
Puheenjohtaja	Sihteerit
Ordförande	Sekreterarna
Kryetari	Sekretari

LIGJ
Nr. 130/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunimin policor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9338, datë 4.12.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Kroacisë (këtu e tutje referuar si Palët Kontraktuese),

në frymën e marrëdhënieve miqësore ndërmjet dy vendeve;

me qëllim përforcimin e bashkëpunimit midis autoriteteve të policisë;

me një vullnet të përbashkët për të marrë pjesë me efikasitet në parandalimin e rreziqeve ndërkombëtare për sigurinë publike dhe parandalimin e kriminalitetit ndërkombëtar;

me qëllim për të vepruar me më shumë efikasitet kundër kriminalitetit ndërkombëtar përmes veprimtarive të koordinuara;

në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve nga Procedimi Automatik i të Dhënave Personale, bërë në Strasburg, më 28 janar 1981, të Protokollit Shtesë të Këshillit të Evropës për Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve nga Procedimi Automatik i të Dhënave Personale lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen ndërkufitare të të dhënave personale", bërë në Strasburg, më 8 nëntor 2001, si edhe Rekomandimin nr. R (87) 15, të Komitetit të Ministrave mbi rregullimin e përdorimit të të dhënave personale të vendeve anëtare në sektorin e policisë, i cili aplikohet edhe në rastet kur të dhënat nuk përpunohen automatikisht,

kanë rënë dakord si vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i Marrëveshjes dhe autoritetet kompetente

Palët Kontraktuese do të forcojnë bashkëpunimin, në fushën e:

- parandalimit dhe eliminimit të kërcënimeve për sigurinë publike dhe rendin publik;
- parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale;
- luftës kundër krimit ndërkufitar; dhe
- trajnimit dhe zhvillimit profesional.

Në përputhje me legjislacionin kombëtar, Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në implementimin e masave të përbashkëta policore brenda fushave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, me stafe të përbashkëta, mbështetje materiale dhe organizative, si dhe kur mundet, me krijimin e skuadrave policore të përbashkëta.

Autoritetet policore kompetente sipas kësaj Marrëveshjeje janë:

- në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si autoritet qendror kombëtar me njësitë e tij të brendshme organizative;
- në Republikën e Kroacisë: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, si autoritet qendror kombëtar me njësitë e tij të brendshme organizative.

Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi çdo ndryshim në kompetencat ose emrat e autoriteteve të referuara në këtë Marrëveshje.

Neni 2
Analiza e përbashkët e riskut

Palët Kontraktuese do të bëjnë përpjekje për të përmbushur statusin më të standardizuar të njoftimit mbi situatën e sigurisë. Për këtë qëllim, kur justifikohet dhe të paktën një herë në vit, ato duhet të përgatisin raporte të përbashkëta të vlerësimit të kërcënimit, e cila do të shërbejë si bazë për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve.

KREU II
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR

Neni 3
Bashkëpunimi sipas kërkesës

Autoritetet e policisë të Palëve Kontraktuese, brenda kompetencave të tyre, sipas kërkesës, do t'i japin njëra-tjetrës asistencë administrative dhe operacionale për eliminimin e kërcënimeve për sigurinë publike dhe rendin publik, si edhe për parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale, përveçse kur në bazë të legjislacionit kombëtar, kompetenca për kërkesën ose për plotësimin e saj, i takon autoriteteve gjyqësore. Nëse autoriteti i kërkuar i policisë nuk është kompetent për të plotësuar kërkesën, kjo do t'i dërgohet organit kompetent.

Autoritetet qendrore kombëtare të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë kërkesa në mënyrë të ndërsjellë sipas paragrafit 1 të këtij neni, si edhe do t'u përgjigjen këtyre kërkesave. Kërkesat do t'u paraqiten drejtpërdrejt autoriteteve qendrore kombëtare të Palëve Kontraktuese, të cilat duhet të japin përgjigje në lidhje me to.

Përveçse kur kërkesat për ndihmë për eliminimin e kërcënimeve imediate ndaj sigurisë publike dhe rendit publik nuk mund të dërgohen në kohën e duhur, përmes kanaleve të rregullta midis autoriteteve qendrore kombëtare, kërkesat dhe përgjigjet mund të paraqiten drejtpërdrejt nëpërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Autoriteti kompetent i policisë do të njoftojë autoritetin e tij qendror kombëtar mbi kërkesat e marra dhe të dërguara në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatim të legjislacionit kombëtar.

Në bazë të legjislacionit kombëtar, kërkesat sipas paragrafëve 1 deri në 3 të këtij neni, mund të lidhen në mënyrë të veçantë me:

1. Përcaktimin e pronarëve dhe drejtuesve të mjeteve të transportit rrugor dhe ajror dhe mjeteve lundruese;
2. Kërkesa mbi lejet e drejtimit të mjetit, licencat e lundrimit dhe licenca të ngjashme;
3. Caktimin e vendbanimit të përhershëm dhe të përkohshëm dhe bazës së tyre ligjore;
4. Caktimin e pronarëve dhe përdoruesve të lidhjeve telefonike ose mjeteve të tjera të telekomunikacionit;
5. Përcaktimin e identitetit;
6. Njoftimet për origjinën e objekteve, p.sh.: armëve, mjeteve motorike dhe anijeve (kërkesa në lidhje me bazën ligjore të tyre);
7. Njoftimet mbi posedimin dhe pronësinë e pasurive të paluajtshme, pasurive të luajtshme dhe letrave me vlerë;
8. Koordinimin dhe fillimin e masave të para të kërkimit;
9. Veprime speciale hetimore;
10. Mbledhjen e informacionit të nevojshëm;
11. Ndërmarrjen e masave konkrete ndërsa sigurohet mbrojtje për dëshmitarët;
12. Zbulimin, sigurimin, analizën dhe krahasimin e gjurmëve daktiloskopike.

Kërkesat, si edhe përgjigjet për to, në parim duhet të paraqiten në formë të shkruar. Nëse janë dorëzuar të dhënat personale, duhet të zgjidhet një mënyrë paraqitjeje, e cila duhet të mbajë parasysh natyrën delikate të të dhënave. Në raste urgjence, kërkesat mund të paraqiten, gjithashtu, edhe me gojë, në këto raste kërkesa pasuese me shkrim do të paraqitet pa vonesë. Palët Kontraktuese garantojnë që vetëm personat e autorizuar do të kenë mundësinë për akses në pajisjet e komunikimit.

Neni 4
Shkëmbimi i informacionit pa kërkesë

Autoritetet kompetente policore të Palëve Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar, në raste të veçanta, do të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion edhe pa kërkesë, nëse në bazë të fakteve mund të prezumohet në mënyrë të arsyeshme, se ky informacion është i nevojshëm për eliminimin e rreziqeve konkrete për sigurinë dhe rendin publik ose ndjekjen e veprave kriminale, ose mund të çojë në paraqitjen e

kërkesës për ndihmë ligjore. Paragrafët 2, 3 dhe 5, të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen për shkëmbimin e informacionit.

Neni 5
Arsimimi dhe zhvillimi profesional

Autoritetet e policisë të Palëve Kontraktuese do të bashkëpunojnë në fushën e arsimimit dhe zhvillimit profesional, veçanërisht përmes:

1. Shkëmbimit të planeve të trajnimit dhe programeve;
2. Seminareve dhe ushtrimeve të përbashkëta, si edhe shkëmbimit të lektorëve dhe ekspertëve në forma të ndryshme të zhvillimit profesional;
3. Ftesës së përfaqësuesve të Palës tjetër Kontraktuese, si vëzhgues gjatë stërvitjeve dhe në veprimtari të veçanta të një rëndësie të lartë për çështjen e sigurisë;
4. Takimeve të përbashkëta të punës.

KREU III
FUSHA TË VEÇANTA TË BASHKËPUNIMIT POLICOR

Neni 6
Bashkëpunimi policor mbi parandalimin e korrupsionit dhe veprave të tjera kriminale kundër detyrës zyrtare

Autoritetet policore të Palëve Kontraktuese do të bashkëpunojnë në parandalimin e korrupsionit dhe veprave të tjera penale kundër veprimtarisë shtetërore.

Bashkëpunimi i autoriteteve të policisë të Palëve Kontraktuese në këtë fushë do të përfshijë edhe shkëmbimin e përvojës lidhur me implementimin e legjislacionit kombëtar dhe parandalimin e krimit, si edhe shkëmbimin e informacionit dhe analizat e shkaqeve dhe tendencave në zhvillim mbi zhdukjen e korrupsionit dhe akteve të tjera kriminale kundër detyrës zyrtare.

KREU IV
LLOJE TË VEÇANTA TË BASHKËPUNIMIT

Neni 7
Dërgesat e kontrolluara

Palët Kontraktuese mund, në bazë të kërkesës së dorëzuar paraprakisht, të lejojnë në territorin e tyre dërgesa të kontrolluara për vepra penale për të cilat është e mundur në zbatim të legjislacionit të Palës Kontraktuese të kërkuar, veçanërisht në rast të trafikimit të paligjshëm të drogës, armëve, lëndëve eksplozivëve, parave të falsifikuara dhe pastrimit të parave. Pala Kontraktuese kërkuese duhet të shpjegojë arsyet për nevojën e kësaj mase dhe se zbulimi i furnizuesve dhe i pjesëmarrësve të tjerë ose kanaleve të shpërndarjes, në të kundërt, do të ishte i pamundur ose më i vështirë. Pala Kontraktuese e kërkuar duhet të kufizojë ose të refuzojë dërgesat e kontrolluara në rast se këto përmbajnë një rrezik të lartë joproporcional për personat që marrin pjesë në transport ose nëse paraqesin rrezik për sigurinë publike.

Pala Kontraktuese e kërkuar merr përsipër kontrollin e dërgesave në çastin e kalimit të kufirit shtetëror, në mënyrë që të shmangë ndërprerjen e kontrollit. Gjatë vazhdimit të mëtejshëm të transportit, Pala Kontraktuese e kërkuar mundëson mbikëqyrje të vazhdueshme në mënyrë të tillë që të lejojë pjesëmarrësit dhe dërgesat të jenë të arritshëm në çdo kohë. Në bazë të marrëveshjes mes Palëve Kontraktuese, dërgesat e kontrolluara mund të ndalohen, dhe pëlqimi për vazhdimin e dërgesës do të jepet vetëm në mënyrë të tillë që të lejojë dërgesën të mbetet e paprekur, të hiqet ose të zëvendësohet pjesërisht ose plotësisht.

Kërkesat për dorëzime të kontrolluara, të cilat fillojnë ose vazhdojnë në një shtet të tretë, do të miratohen vetëm nëse ai shtet mundëson plotësim të kushteve të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.

Kërkesat e përmendura në paragrafin 1 do të paraqiten:

- në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda;
- në Republikën e Kroacisë: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Policisë Kriminale.

Kërkesa referuar paragrafit 1 do të paraqitet në bazë të legjislacionit kombëtar sipas kushtit të reciprocitetit. Vendimi do të merret nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese të kërkuar.

Neni 8
Hetime të agjentëve të policisë nën mbulim dhe informatorëve të infiltruar

Palët Kontraktuese mund, me anë të një kërkese të paraqitur paraprakisht, t'i japin njëra-tjetrës

ndihmë për kryerjen e hetimeve duke përdorur persona zyrtarë si agjentë të policisë nën mbulim ose me identitet të ndryshuar (agjentë nën mbulim) apo informatorë të besuar, nëse ekziston një dyshim që një vepër penale është kryer, për të cilën lejohen veprime të agjentëve të policisë nën mbulim ose informatorë të infiltruar sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese të kërkuar. Pala Kontraktuese kërkuese duhet të japë arsye për nevojën e kësaj mase dhe se pa një masë të tillë mbledhja e informacionit do të bëhej e pamundur ose shumë më e vështirë.

Hetimet e agjentëve të policisë nën mbulim dhe informatorëve të infiltruar në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar do të kufizohet në veprimtari individuale të limituara, në kohë ose në çdo mënyrë tjetër të përcaktimit të aktiviteteve, sipas legjislacionit kombëtar. Operacionet do të përgatiten në bazë të marrëveshjes midis autoriteteve pjesëmarrëse të Palëve Kontraktuese kërkuese dhe të kërkuar. Operacionet do të drejtohen nga personi zyrtar i Palës Kontraktuese të kërkuar. Me kërkesë të njërës prej Palëve Kontraktuese, operacionet e agjentëve të policisë nën mbulim dhe të informatorëve të infiltruar duhet të pushohen pa asnjë vonesë.

Me kërkesë të Palës Kontraktuese kërkuese, një agjent i policisë nën mbulim të Palës Kontraktuese kërkuese ose një person i infiltruar mund të punësohet në territorin shtetëror të Palës Kontraktuese të kërkuar, duke marrë në konsideratë kufizimet e përmendura në paragrafin paraardhës. Pala Kontraktuese e kërkuar duhet të mundësojë mbështetje me staf, logjistikë dhe ndihmë teknike. Pala Kontraktuese e kërkuar duhet të ndërmarrë të gjitha masat e kërkuara për mbrojtjen e personave zyrtarë ose informatorëve të infiltruar të Palës Kontraktuese kërkuese gjatë aktiviteteve të tyre në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar. Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës u kryen aktivitetet, duhet të njoftohen me shkrim pa vonesë mbi zbatimin dhe rezultatet e veprimtarisë së agjentëve të policisë nën mbulim dhe informatorëve të infiltruar. Operacionet e agjentëve të policisë nën mbulim dhe informatorëve të infiltruar të Palës Kontraktuese kërkuese konsiderohen si operacione të Palës Kontraktuese të kërkuar.

Pala Kontraktuese e kërkuar në bazë të legjislacionit kombëtar do të vendosë kushte paraprake për operacionet e agjentëve të policisë nën mbulim apo të informatorëve të infiltruar, kushte për punësimin e tyre dhe kushte për përdorimin e rezultateve të investigimeve të tyre. Pala Kontraktuese e kërkuar informon Palën Kontraktuese kërkuese për to.

Kërkesat referuar paragrafit 1 do të paraqiten:

- në Republikën e Shqipërisë: Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- në Republikën e Kroacisë: Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Policisë Kriminale.

Kërkesa referuar paragrafit 1 do të paraqitet në bazë të legjislacionit kombëtar sipas kushtit të reciprocitetit. Vendimi do të merret nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të kërkuar në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese të kërkuar.

Neni 9

Mbrojtja e dëshmitarëve

Autoritetet policore të Palëve Kontraktuese ndihmojnë njëra-tjetrën në mënyrë reciproke në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve ose të personave të tjerë në zbatim të legjislacionit të tyre kombëtar (më tutje referuar si "persona në nevojë për mbrojtje").

Kjo ndihmë përfshin shkëmbimin e informacionit, ndihmën logjistike dhe pritjen e personave në nevojë për mbrojtje.

Një person në nevojë për mbrojtje duhet të përfshihet në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të Palës Kontraktuese kërkuese. Ky person nuk do të përfshihet në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të Palës Kontraktuese të kërkuar. Legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese të kërkuar aplikohet përkatësisht gjatë ndërmarrjes së masave të ndihmës lidhur me mbrojtjen e këtyre personave.

Nëse kërkohet, shpenzimet e jetesës së personave që kanë nevojë për mbrojtje, si edhe shpenzime të tjera për masa të tjera, zbatimi i të cilave është kërkuar nga Pala Kontraktuese kërkuese mbulohen nga shteti kërkues. Shpenzimet e oficerëve të policisë dhe kostot materiale lidhur me mbrojtjen e këtyre personave mbulohen nga Pala Kontraktuese e kërkuar.

Pala Kontraktuese e kërkuar, pasi të informojë paraprakisht Palën Kontraktuese kërkuese, mund të pushojë së siguruari mbrojtjen e personit që ka nevojë për mbrojtje, nëse ka arsye serioze për këtë veprim të tillë. Në raste të tilla, Pala Kontraktuese kërkuese duhet ta marrë përsëri në dorëzim atë person.

Neni 10
Caktimi i oficerëve të kontaktit

Një Palë Kontraktuese mund të caktojë një oficer kontakti pranë autoriteteve policore të Palës tjetër Kontraktuese me aprovimin e autoritetet qendror kombëtar të saj.

Oficerët e kontaktit shërbejnë për këshillime dhe asistencë pa pasur të drejta për të ushtruar në mënyrë të pavarur të tagrave policore. Ata do të sigurojnë informacion dhe ndërmarrin detyra brenda kuadrit të instruksioneve të Palës Kontraktuese caktuese dhe, në të njëjtën kohë, ata marrin në konsideratë kërkesat nga Pala Kontraktuese pritëse.

Oficerët e kontaktit, që caktohen nga një Palë Kontraktuese në një vend të tretë, në bazë të një marrëveshjeje të përbashkët nga të dyja Palët Kontraktuese dhe sipas një miratimi me shkrim nga shteti i tretë mund të mbrojnë interesat e Palës tjetër Kontraktuese në atë shtet.

Neni 11
Pikat e kontaktit

Me qëllim thjeshtimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes autoriteteve policore kompetente të Palëve Kontraktuese, persona zyrtarë nga autoritetet kompetente policore të njërës prej Palëve Kontraktuese mund të caktohen pranë shërbimeve të pikave të kontaktit të ndara me Palën tjetër Kontraktuese dhe shtete të treta, në bazë të pëlqimit me shkrim të vendeve të treta.

Neni 12
Bashkëpunimi në fushën e sigurisë gjatë sporteve dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë dhe do të shkëmbejnë informacion lidhur me aktivitetet sportive dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme.

Shkëmbimi i informacionit do të përshijë edhe dorëzimin e të dhënave personale mbi tifozët dhe personat që janë të prirur ndaj dhunës gjatë garave sportive të përmendura sipas legjislacionit kombëtar.

Bashkëpunimi mund të përfshijë dërgimin dhe pritjen e ekipeve policore gjatë aktiviteteve sportive të përmendura më sipër dhe ngjarjeve të tjera të mëdha dhe aktivitetet e tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, si edhe shkëmbimin e përvojës me qëllim përftimin e praktikave më të mira. Shkëmbimi i përvojës përfshin: shkëmbimin e ekspertëve, dokumenteve, njohurive specifike brenda kësaj fushe.

Neni 13
Komunikimi i ndërsjellë dhe lidhjet e telekomunikacionit

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet policore mund të përmirësojnë komunikimin e përbashkët dhe lidhjet e telekomunikimit midis tyre nëpërmjet:

1. Caktimit të personave të kontaktit;
2. Shkëmbimit të informacionit mbi lidhjet e rëndësishme të telekomunikacionit dhe adresat elektronike të autoriteteve të policisë;
3. Mundësimit të lidhjeve direkte për transmetimet e fjalimit, të dhënave ose pamjeve;
4. Vendosjes së lidhjeve radio mbi frekuencat e rëna dakord në rast se ka nevoja të veçanta; dhe
5. Bashkëpunimit për mundësimin e një operacioni të rregullt nga sistemet radio të policisë.

KREU VI
MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 14
Mbrojtja e të dhënave personale

Autoritetet kompetente policore të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë të dhëna personale (më poshtë të referuara si "të dhëna") duke respektuar kufizimet e vendosura nga autoritetet që dërgojnë këto të dhëna, në bazë të parimeve të mëposhtme që zbatohen në mënyrë të barabartë për të dhënat që përpunohen në mënyrë automatike dhe të dhënat që nuk përpunohen në atë mënyrë:

1. Të dhënat e paraqitura nuk mund të përdoren për ndonjë arsye tjetër, përveç asaj për të cilën janë dërguar, pa pasur miratimin e autoritetit që ka dërguar këto të dhëna.
2. Të dhënat e dërguara do të fshihen ose korrigjohen, sapo:

- vendoset mbi pakorrektësinë e të dhënave; ose
- autoriteti që ka dërguar të dhënat njofton që të dhënat e dërguara janë përcaktuar ose janë dërguar në mënyrë të paligjshme; ose
- nuk janë më të nevojshme për zbatimin e detyrës zyrtare për të cilën janë dërguar, me përjashtim të rastit kur ekziston një autorizim i qartë për përdorimin e të dhënave të dërguara për ndonjë qëllim tjetër. Ky autorizim mund të jepet vetëm nëse përpunimi i këtyre të dhënave për qëllime të tjera lejohet në bazë të legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese që regjistron këto të dhëna.

Palët Kontraktuese duhet të ndjekin udhëzimet e Palës Kontraktuese që dërgon të dhënat lidhur me detyrimin për të fshirë të dhënat.

3. Me kërkesë të autoritetit kompetent që dërgon të dhënat, marrësi do të japë informacion mbi përdorimin e të dhënave të marra dhe mbi rezultatet e arritura.

4. Autoriteti kompetent që dërgon të dhënat garanton që të dhënat e dërguara të jenë të sakta dhe të përditësuara. Për më tepër, vëmendje duhet t'i kushtohet ekzistencës së nevojës dhe proporcionalitetit të lidhur me qëllimin e dorëzimit të të dhënave, si edhe respektimit të ndalimeve lidhur me dërgimin e të dhënave në baza të legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese. Nëse vendoset që të dhënat e dërguara janë të pasakta ose të dhënat nuk duhet të dërgoheshin apo të dhënat e dërguara rregullisht duhet të fshihen me skadimin e afatit specifik në bazë të legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese, autoriteti i së cilës ka dërguar këto të dhëna, marrësi duhet të informohet menjëherë për këtë. Marrësi është i detyruar të ndërmarrë fshirjen ose korrigjimin e kërkuar të të dhënave pa vonesë.

5. Nëse autoriteti që merr këto dhëna ka arsye të dyshojë lidhur me korrektësinë e të dhënave të dërguara ose beson se ato duhet të fshihen, ai është duhet të informojë menjëherë autoritetin dërgues të të dhënave.

6. Për dërgimin e të dhënave, Palët Kontraktuese duhet të përdorin vetëm ato mjete të komunikimit, të cilat garantojnë një mbrojtje efikase të të dhënave nga përdorimi i paautorizuar ose modifikimi nga personat e tretë gjatë procesit të dërgimit të këtyre të dhënave.

7. Personat zyrtarë, që veprojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, nuk do të kenë akses direkt në përpunimin automatik të të dhënave të Palës tjetër Kontraktuese. Kjo do të zbatohet edhe për bashkëpunimin sipas nenit 15.

8. Marrësi duhet të mbrojë me efikasitet të dhënat e dërguara nga dëmtimi aksidental ose i paautorizuar, humbja aksidentale, modifikimi aksidental ose i paautorizuar, ose nga publikimi i paautorizuar.

9. Autoriteti që dërgon të dhënat dhe marrësi janë duhet të regjistrojnë arsyen, përmbajtjen, orën dhe vendin e marrjes, si edhe autoritetin dërgues të të dhënave dhe autoritetin që mori të dhënat. Këto të dhëna do të ruhen për të paktën tre vjet dhe mund të përdoren vetëm për mbikëqyrjen në respektim të rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave.

10. Në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare, Palët Kontraktuese do të jenë përgjegjëse për dëm të shkaktuar në njërën prej Palëve Kontraktuese për çdo subjekt të të dhënave të Palës tjetër Kontraktuese, i cili është shkaktuar si pasojë e përpunimit të të dhënave të subjektit të dërguara në zbatim të kësaj Marrëveshjeje. Brenda përgjegjësive të tyre dhe në zbatim të legjislacionit të tyre kombëtar, Palët Kontraktuese mund të mos i referohen një pale të dëmtuar duke pretenduar se të dhënat e dërguara nuk janë të sakta ose që janë paraqitur në mënyrë të paligjshme. Nëse Pala Kontraktuese që ka marrë të dhënat, kompenson për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i parregullt ose dërgimi i paligjshëm i të dhënave, Pala Kontraktuese që ka dërguar këto të dhëna do të paguajë për shumën totale të paguar për zhdëmtimin.

Neni 15

Informacioni i klasifikuar

Informacioni i klasifikuar në këtë Marrëveshje do të shkëmbehet në përputhje me Marrëveshjen midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë mbi mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, nënshkruar më 19 dhjetor 2008.

KREU VI
STATUSI LIGJOR I PERSONAVE ZYRTARË

Neni 16
Tagrat dhe statusi ligjor i personave zyrtarë të Palës tjetër Kontraktuese

Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat zyrtarë të njërës Palë Kontraktuese, që janë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, me qëllim bashkëpunimin nën këtë Marrëveshje nuk do të kenë kompetenca policore ekzekutive. Gjatë marrjes së të gjithave masave në kryerjen e detyrave, ata duhet të respektojnë legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese.

Personat zyrtarë të njërës prej Palëve Kontraktuese, të cilët në kuadër të bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje, qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, janë të detyruar të mbajnë një mjet zyrtar identifikimi me fotografi. Në rastet referuar nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, është mjaftueshme mbajtja e një dokumenti që tregon identitetin sekret.

Personat zyrtarë të njërës prej Palëve Kontraktuese, të cilët qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në kuadër të bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të autorizuar të mbajnë armët e tyre të shërbimit, mjetet dhe pajisjet bazë të shtrëngimit, përveçse Pala tjetër Kontraktuese deklaron në raste të veçanta se nuk lejon këtë apo e lejon vetëm në kushte të posaçme për raste të veçanta. Përdorimi i armëve të shërbimit do të lejohet vetëm në rastin e vetëmbrojtjes apo në mbrojtjen e personave të tretë. Shërbimet kompetente do t'i njoftojnë reciprokisht njëra-tjetrës për armët e shërbimit të miratuara dhe mjetet e tjera të shtrëngimit. Personat zyrtarë nuk do të jenë të autorizuar të mbajnë uniformë shërbimi. Personat zyrtarë të përmendur në nenet 14, 15 dhe 17, të kësaj Marrëveshjeje, do të autorizohen të mbajnë uniforma shërbimi, përveçse nëse kjo nuk lejohet ose është e kushtëzuar vetëm për një rast specifik nga autoritetet policore kompetente në territorin e të cilave veprojnë personat zyrtarë.

Nëse personat zyrtarë të njërës prej Palëve Kontraktuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë sipas kësaj Marrëveshjeje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese përdorin automjete, ata duhet respektojnë të njëjtat rregullore qarkullimi si personat zyrtarë të Palës tjetër Kontraktuese. Palët Kontraktuese njoftojnë reciprokisht njëra-tjetrën mbi rregulloret e vlefshme në këtë fushë.

Neni 17
Përgjegjësia penale

Personat zyrtarë, që operojnë sipas kësaj Marrëveshjeje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të trajtohen si të barabartë në të drejtat dhe detyrimet lidhur me veprat penale të kryera prej tyre ose kundër tyre ose në dëm të tyre, si personat zyrtarë të asaj Pale Kontraktuese.

Neni 18
Marrëdhëniet e punësimit

Dispozitat e ligjeve të shteteve të tyre për punësimin, veçanërisht në lidhje me përgjegjësinë disiplinore, do të zbatohen për personat zyrtarë të Palëve Kontraktuese gjatë kryerjes së detyrave të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19
Përgjegjësia për dëmet

Nëse një person zyrtar i njërës prej Palëve Kontraktuese shkakton dëm gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kjo Palë Kontraktuese është përgjegjëse për dëmet e një pale të tretë të cenuar, sipas kushteve të barabarta dhe brenda të njëjtit qëllim sikur dëmi të jetë shkaktuar nga personat zyrtarë të saj, që kanë juridiksion lëndor dhe tokësor.

Pala Kontraktuese që ka zhdëmtuar dëmin e palëve të prekura ose të trashëgimtarëve të tyre të ligjshëm, duhet të kompensohet për shumën e dëmit nga Pala tjetër Kontraktuese, përveçse kur ndërhyrja përputhet m kërkesën e saj. Në rastin kur Palët Kontraktuese, do të ngarkohen për dëmet, kompensimi nuk do të kërkohet, përveç kur personi zyrtar e ka shkaktuar këtë dëm me qëllim ose si pasojë e neglizhencës së rëndë.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDME

Neni 20
Refuzimi i bashkëpunimit

Nëse njëra Palë Kontraktuese vlerëson se veprimi mbi një kërkesë specifike ose ndërmarrja e një mase konkrete bashkëpunimi në zbatim të

kësaj Marrëveshjeje është e tillë që mund të çojë në kufizime të sovranitetit, në kërcënim të sigurisë së vet dhe të interesave të tjera të rëndësishme, ose është në kundërshtim me legjislacionin kombëtar, ajo duhet të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese për refuzimin e plotë ose pjesshëm të bashkë-punimit apo pranimin sipas disa kushteve të caktuara.

Neni 21
Protokollet e zbatimit

Autoritetet qendrore kombëtare kompetente të Palëve Kontraktuese, të përmendura në paragrafin 3, të nenit 1, mund të lidhin protokolle për zbatimin e neneve 10, 12, 13 dhe 14, të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22
Takimet e ekspertëve

Secila Palë Kontraktuese, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë një takim të përfaqësuesve të autoriteteve policore kompetente të Palëve Kontraktuese me qëllim përcaktimin e detajeve për implementimin e mënyrave të bashkëpunimit të parashikuara nga kjo Marrëveshje, zgjidhjen e çështjeve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe propozimin e zhvillimeve të mëtejshme për bashkëpunim.

Neni 23
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, të cilat autoritetet kombëtare nuk mund t'i zgjidhin nëpërmjet konsultimeve do të zgjidhen përmes kanaleve diplomatike.

Neni 24
Shpenzimet

Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, secila Palë Kontraktuese do të mbulojë shpenzimet e bëra nga autoritetet e saj policore gjatë implementimit të kësaj Marrë-veshjeje.

Neni 25
Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.

Kjo Marrëveshje nuk do të prekë dispozitat për bashkëpunim ndërkombëtar për luftën kundër kriminalitetit ndërmjet autoriteteve qendrore kombëtare, veçanërisht brenda strukturës së Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

Neni 26
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e tridhjetë, pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike se procedurat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje janë përmbushur.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese në çdo kohë, mund të përfundojë këtë Marrëveshje me njoftim me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë gjashtë muaj nga marrja e njoftimit të përfundimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja mbi bashkëpunimin ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë për luftën kundër terrorizmit, trafikimit dhe abuzimit të drogave dhe krimit të organizuar, bërë në Zagreb, më 14 dhjetor 1993, do të pushojë së pasuri efekt.

Nënshkruar në Tiranë, më 20 janar 2014, në dy origjinale, në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze, duke qenë të tria tekstet njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

LIGJ
Nr. 131/2015

PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e veprimit

Ky ligj përcakton rregullat për organizimin e funksionimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 2
Krijimi dhe statusi i QKB-së

1. Krijohet Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim "QKB").

2. QKB-ja është institucion i administratës shtetërore me personalitet juridik në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë (në vijim "ministri") dhe e ka selinë në Tiranë.

3. QKB-ja financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

Neni 3
Funksionet

1. QKB-ja ka këto funksione:

a) mban regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit;

b) kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit;

c) kryen regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës;

ç) lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, sipas përcaktimit të ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit;

d) publikon të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;

dh) trajton procedurat e licencimit, të autorizimit apo të lejeve, të ndryshimit dhe revokimit të tyre, sipas ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;

e) mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;

ë) siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;

f) informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit;

g) jep mendim për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licencave, autorizimeve e lejeve;

gj) kryen studime për cilësinë e mjedisit rregullator, mbështet me informacion, analiza e këshilla ministrin, Këshillin e Ministrave apo institucionet qendrore dhe të pavarura, në lidhje me nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licencave, autorizimeve e lejeve, si dhe asiston në përgatitjen e politikave për përmirësimin e mjedisit rregullator në këto fusha.

2. Procedurat për ushtrimin funksioneve të QKB-së, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit dhe në ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet.

3. QKB-ja ka pavarësi të plotë në vendimmarrjen për çështje konkrete në realizimin e funksioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 4
Organizimi dhe sportelet e shërbimit të QKB-së

1. QKB-ja ka juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është institucioni i vetëm që ofron shërbim ndaj publikut, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. QKB-ja ushtron funksionet e saj drejtpërdrejt për publikun, nëpërmjet sportelit të saj qendror dhe nëpërmjet sporteleve të shërbimit në territor.

3. QKB-ja ofron shërbim në territor, nëpërmjet sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore, si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. QKB-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi me njësinë e qeverisjes vendore, ku përcaktohen kushtet e ofrimit të shërbimit dhe treguesit kryesorë të performancës, kualifikimet dhe kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve të sportelit, si dhe trajnimet e detyrueshme për nëpunësit.

4. QKB-ja ofron shërbim në territor edhe nëpërmjet sporteleve të shërbimit, të hapura në bashkëpunim dhe pranë Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose dhomave të

tregtisë rregulluar sipas legjislacionit përkatës. Hapja e këtyre sporteleve bëhet në marrëveshje me këto organizata, të cilave u delegohen funksionet e sportelit të QKR-së, në përputhje me kushtet e këtij ligji dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit.

5. Numri dhe vendndodhja e sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore apo organizatave të tjera, të përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, miratohen nga ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, në bazë të planifikimit të nevojës për hapjen e sporteleve të shërbimit në territor dhe ngarkesës së mjaftueshme të veprimeve në sportele.

6. Në rast se njësia përkatëse e qeverisjes vendore apo organizata, me të cilën QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, sipas këtij neni, nuk ofron shërbimin e sportelit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji apo me parashikimet e marrëveshjes së lidhur me QKB-në, titullari i QKB-së ka të drejtë t'i propozojë ministrit mbylljen e sportelit përkatës.

7. Në rastet e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, QKB-ja, në bazë të vlerësimit paraprak të nevojës së hapjes së sporteleve në territor dhe të ngarkesës së mjaftueshme të veprimeve në sportelin përkatës, mund të zëvendësojë sportelin e mbyllur, duke hapur një sportel shërbimi, në kuadër të strukturës së saj, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të këtij ligji.

8. Të gjitha sportelet e shërbimit në territor lidhen *on-line* me sistemin qendror të QKB-së.

9. QKB-ja mund të kryejë funksionet e saj sipas këtij ligji edhe nëpërmjet hapjes së një sporteli elektronik për kryerjen e procedurave përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe të ligjit që rregullon licencat, lejet dhe autorizimet.

Neni 5
Drejtimi i QKB-së

1. Veprimtaria e QKB-së drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar e të burimeve njerëzore të QKB-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Drejtori i Përgjithshëm i QKB-së ushtron udhëheqjen metodologjike për zbatimin e procedurave që ndiqen sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe ligjit që rregullon licencat, autorizimet e lejet dhe nxjerr, për këtë qëllim, urdhra e udhëzime të detyrueshme për nëpunësit e QKB-së dhe për të gjitha sportelet e shërbimit.

Neni 6
Organizimi i brendshëm

Organizimi i brendshëm i QKB-së miratohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7
Nëpunësit dhe punonjësit administrativë të QKB-së

1. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të QKB-së, përfshirë nëpunësit e sportelit qendror të shërbimit dhe të sporteleve të shërbimit, të krijuara sipas pikës 7, të nenit 4, të këtij ligji, rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të QKB-së rregullohen sipas Kodit të Punës.

Neni 8
Nëpunësit që ushtrojnë funksione të deleguara

1. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, të hapura nga QKB-ja, sipas pikës 3, të nenit 4, të këtij ligji, janë nëpunës civilë të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, të hapura nga QKB-ja, sipas pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji, janë punonjës të organizatës përkatëse, me të cilën QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

3. Me qëllim njësimin e shërbimit që i ofrohet publikut në të gjitha sportelet e shërbimit në territor, nëpunësit e sporteleve të shërbimit duhet të plotësojnë të njëjtat kritere të posaçme profesionale që zbatohen për nëpunësit e sportelit qendror të QKB-së. QKB-ja siguron për nëpunësit e sporteleve të shërbimit të njëjtin trajnim që zbatohet për nëpunësit e sportelit qendror të kësaj qendre.

Neni 9
Pagat

1. Struktura dhe nivelet e pagave dhe të shpërblimit të QKB-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Niveli i pagave dhe i shpërblimit, si dhe numri i nëpunësve apo punonjësve të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 8, të këtij ligji, përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht, nga njësitë e qeverisjes vendore apo subjektet e tjera, me të cilat QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 10
Buxheti i QKB-së

1. Buxheti i QKB-së është pjesë përbërëse e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për tregtinë dhe përgatitet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Buxheti i QKB-së përbëhet nga të ardhurat që realizohen, sipas këtij ligji, nga të gjitha sportelet e shërbimit dhe nga të gjitha shpenzimet e kësaj qendre, përfshirë fondet për shpenzime operative dhe kapitale për sportelet e shërbimit, që krijohen sipas pikave 3, 7 dhe 9, të nenit 4, të këtij ligji. Fondet për funksionimin e QKB-së janë fonde buxhetore.

3. Fondet për shpenzime korrente për çdo sportel shërbimi të krijuar sipas pikës 3, të nenit 4, të këtij ligji, janë fonde të kushtëzuara dhe përcaktohen në buxhetin e QKB-së, në bazë të rregullave të planifikimit e të zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

4. Shpenzimet për hapjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sporteleve të shërbimit, sipas pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji, me përjashtim të fondeve për kryerjen e trajnimeve për punonjësit e sportelit, që përballohen nga QKB-ja, mbulohen nga subjektet përkatëse dhe nuk janë pjesë e buxhetit të QKB-së.

5. Njësia e qeverisjes vendore apo subjekti tjetër, me të cilin QKB-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi, në përputhje me objektivat e vet, mund të parashikojë dhe të kryejë shpenzime operative ose kapitale shtesë për përmirësimin e shërbimeve në sportelin përkatës.

Neni 11
Shërbimet e tarifat

1. QKB-ja realizon të ardhura nga kryerja e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera shtesë, në mbështetje të këtyre funksioneve.

2. Ministri përcakton shërbimet e tjera shtesë, që ofrohen nga QKB -ja, tarifat e të cilave miratohen, me propozimin e tij, nga Ministri i Financave.

3. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet, që lidhen me kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

4. Të gjitha tarifat shpallen në çdo sportel shërbimi dhe në faqen e internetit të QKB-së.

Neni 12
Përdorimi i të ardhurave

1. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për kryerjen e funksioneve, sipas nenit 3, të këtij ligji, përfshirë edhe ato të krijuara në sportelet e shërbimit, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Të ardhurat nga tarifat për shërbimet e tjera shtesë, të krijuara nga QKB-ja nëpërmjet sportelit qendror apo nëpërmjet sporteleve të shërbimit, sipas pikave 4, 5, 7 apo 9, të nenit 4, të këtij ligji, derdhen vetëm në masën 10 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 90 për qind përdoret nga QKB-ja për përmirësimin e funksionimit të shërbimeve. Mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe Ministrit të Financave.

Neni 13
Raportimi dhe mbikëqyrja

1. Ministri miraton objektivat specifikë të punës dhe treguesit e cilësisë së shërbimeve që kryen QKB-ja dhe mbikëqyr arritjen e tyre.

2. QKB-ja i raporton ministrit për menaxhimin administrativ, financiar dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit.

3. Ushtrimi i mbikëqyrjes nga ministri, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk shtrihet mbi vendimmarrjen për çështje konkrete në ushtrimin e funksioneve të QKB-së, të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 14
Statuti i QKB- së

1. Statuti i QKB-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Statuti përmban rregulla të detajuara për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të QKB-së.

KREU II
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 15
Inventarizimi

Brenda një afati prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, titullari i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe titullari i Qendrës Kombëtare të Licencimit inventarizojnë gjendjen e aktiveve dhe pasiveve të institucioneve përkatëse, numrin dhe vendndodhjen e sporteleve të shërbimit, kontratat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, që këto institucione kanë me palë të treta, formularët e aplikimit, formatet e certifikatave dhe dokumentet e tjera që përdoren për kryerjen e procedurave të regjistrimit të biznesit e të licencimit, autorizimit e lejimit, sipas ligjeve përkatëse, dhe ia vënë këto në dispozicion ministrit.

Neni 16
Aktet nënligjore

1. Ministri, brenda një afati prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, cakton titullarin e QKB-së, në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

2. Brenda një afati prej 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, me propozimin e ministrit:

a) Këshilli i Ministrave miraton statutin e QKB-së, sipas nenit 14, të këtij ligji;

b) Kryeministri miraton strukturën dhe organikën e QKB-së, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji.

3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së dhe brenda një afati prej 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, numrin dhe vendndodhjen e sporteleve të QKB-së, në përputhje me parashikimet e pikave 4 dhe 5, të nenit 4, të këtij ligji.

4. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së dhe brenda një afati prej 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, miraton, sipas pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, formatin e formularëve, certifikatave dhe të dokumenteve të tjera procedurale për kryerjen nga QKB-ja të funksioneve të regjistrimit të biznesit dhe të licencimit e të lejimit, në përputhje me parashikimet e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Ndryshime në legjislacion

1. Në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i ligjit nga "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ndryshohet në "Për regjistrimin e biznesit";

b) Neni 1, "Objekti i ligjit", ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon mënyrën e administrimit të regjistrit tregtar, përcakton subjektet që regjistrohen dhe procedurat e regjistrimit.".

c) Kreu II, "Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit", që përfshin nenet nga 3 deri në 17, shfuqizohet në tërësinë e tij;

ç) Kudo, në ligj, emërtimi "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" dhe shkurtimi "QKR" ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me "Qendra Kombëtare e Biznesit" dhe "QKB".

2. Në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

a) Në nenin 2, pika 1, shkronja "d" shfuqizohet.

b) Në nenin 3, pika 1, shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) "Ministria" është ministria përgjegjëse për tregtinë.".

c) Në nenin 3, pika 1, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) "Ministër" është ministri përgjegjës për tregtinë.".

ç) Kreu VI, "Krijimi, organizimi dhe funksionimi i QKL-së", i cili përfshin nenet nga 37 deri në 51, shfuqizohet në tërësinë e tij.

d) Kudo, në ligj, emërtimi "Qendra Kombëtare e Licencimit" dhe shkurtimi "QKL" ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me "Qendra Kombëtare e Biznesit" dhe "QKB".

3. Në çdo ligj tjetër apo akt nënligjor në fuqi, emërtimi "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" apo shkurtimi "QKR", si dhe emërtimi "Qendra Kombëtare e Licencimit" apo shkurtimi "QKL" ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me "Qendra Kombëtare e Biznesit" dhe "QKB".

4. Në çdo ligj tjetër apo akt nënligjor në fuqi, referencat në një dispozitë të ligjit nr. 9723, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ndryshohen si referenca në dispozitën korresponduese të ligjit "Për regjistrimin e biznesit".

Neni 18
Fillimi i funksionimit të QKB-së

1. Qendra Kombëtare e Biznesit fillon ushtrimin e funksioneve të saj në datën e hyrjes në fuqi të nenit 17, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 21, të këtij ligji.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të nenit 17, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 21, të këtij ligji:

a) Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit shpërbëhen dhe të gjitha aktivet e pasivet e këtyre institucioneve, në atë datë, i transferohen automatikisht QKB-së;

b) QKB-ja trashëgon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Qendrës Kombëtare të Licencimit;

c) të gjitha sportelet e shërbimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Qendrës Kombëtare të Licencimit, që përfshihen në sportelet e miratuara sipas shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 16, të këtij ligji, i transferohen QKB-së, ndërsa sportelet e tjera mbyllen;

ç) të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në fuqi, të lidhura nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit me palë të treta i transferohen QKB-së;

d) buxhetet e miratuara për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrën Kombëtare e Licencimit, sipas ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", do të bashkohen, duke përbërë buxhetin e miratuar të QKB-së.

Neni 19
Procedurat në proces

Procedurat, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, dhe ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, të cilat, në datën e shpërbërjes së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Qendrës Kombëtare të Licencimit, sipas këtij ligji, nuk kanë përfunduar ende, do të vijojnë të kryhen nga QKB-ja, pa pasur asnjë detyrim shtesë në ngarkim të subjekteve përkatëse që kanë aplikuar për këto procedura.

Neni 20
Vlefshmëria e dokumenteve

Dokumentet e lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe përkatësisht ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet, përpara datës së hyrjes në fuqi të nenit 17, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 21, të këtij ligji, mbeten të vlefshme për çdo qëllim ligjor dhe subjektet që janë pajisur me to nuk detyrohen të kryejnë asnjë veprim shtesë.

Neni 21
Hyrja në fuqi

1. Ky ligj, me përjashtim të nenit 17, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Neni 17 i këtij ligji hyn në fuqi 90 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 1 të këtij neni.

Miratuar në datën 26.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9339, datë 4.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 205 lekë